



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjies, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerina Krasniqi, (udhëheqëse ekipi), Laureta Matoshi dhe Veton Misiri (anëtarë ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Faruk Rrahmani.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	7
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	9
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	29
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	35
Shtojca II: Letër Konfirmim	38

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përgatitur dhe menaxhuar mirë, me përjashtim të disa çështjeve të keq klasifikimit të shpenzimeve dhe shpalosjeve të pasurisë që i kemi theksuar më poshtë tek kategoritë përkatëse.

Ministria në përgjithësi, ka vendosur kontrolle efektive për menaxhimin e të hyrave përderisa për një menaxhim financiar dhe kontroll të mirëfilltë të shpenzimeve, ende nevojiten veprime shtesë.

Proceset e menaxhimit të shpenzimeve dhe pasurive ishin përcjell me mjaft mangësi. Mangësitë më të theksuara ishin në menaxhimin e prokurimeve, personelit, subvencioneve, dhe të pagesave me vendime gjyqësore. Menaxhimi i pasurive nuk ishte në nivelin e kërkuar pasi që pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet dhe sistemi e-Pasuria në disa prej njësive nuk ishte funksional.

Zbatimi i rekomandimeve ende mbetet sfidë për ministrinë. Nga 13 rekomandimet e vitit paraprak, katër rekomandime janë zbatuar, tri ishin adresuar pjesërisht, tri nuk janë adresuar ende dhe tri të mbyllura. Si rezultat i përsëritjes së rekomandimeve, shumë mangësi në sistemet domethënëse të ministrisë mbasin të pa trajtuara.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin¹ të këtij raporti.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Menaxhmenti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të MASHT-it gjatë gjithë procesit të auditimit.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga MASHT. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se përmes planifikimit buxhetor MASHT ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 1,191,332€ në kategori ekonomike jo adekuate. Më gjerësisht shih tek nënkapitullin 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Opinioni jonë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Ministria ka shpenzuar 86% të buxhetit final për vitin 2019. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive përderisa kontrollet e vendosura në fushën e shpenzimeve kërkojnë përmirësime të domosdoshme përmes veprimeve konkrete.

Fushat me probleme të theksuara të shpenzimeve kanë të bëjnë me menaxhimin e financave që ndërlidhen me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, anashkalimin e rregullave dhe procedurave të prokurimit, procesin e vlerësimit të ofertave si dhe në menaxhimin e dhënies së subvencioneve. Me tutje, pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet dhe sistemi e-Pasuria në disa prej njësive nuk ishte funksional përderisa niveli i pagesave me vendime gjyqësore kishte rritur kostot për shkak të pagesës edhe të shpenzimeve gjyqësore - përmbartimore.

Menaxhimi i personelit ka mangësi të theksuara që si rezultat ka prodhuar vendosjen e personelit të dyfishuar për pozitat e njëjta të punës, angazhimin e punonjësve me MSHV pa respektuar procedurat, mungesa e monitorimit të vijueshmërisë të punonjësve në punë, si dhe pagesat e parregullta të stafit në Universitete për pjesëmarrje nëpër komisione.

Sistemet e kontrollit të brendshëm, vendosja e raportimit të qartë në ndarjen dhe monitorimin e përgjegjësive dhe detyrave të personelit kanë nevojë për përmirësime.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	73,238,320	72,595,556	62,770,301	86%	49,447,601	41,528,363
Granti i Qeverisë - Buxheti	60,801,974	59,324,861	54,136,376	91%	44,820,362	39,295,443
Financimi nga huamarrja	3,280,843	2,618,586	947,534	36%	727,023	384,861
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	1,296,189	873,166	67%	669,512	681,354
Të hyrat vetjake ⁴	2,655,503	2,655,503	1,130,159	43%	1,018,084	1,032,422
Të hyrat nga AKP ⁵	6,500,000	6,000,000	5,329,825	89%	1,999,677	-
Donacionet e brendshme	-	40,250	23,824	59%	1,465	-
Donacionet e jashtme	-	660,166	329,417	50%	211,478	134,283

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 642,764€. Ky zvogëlim është rezultat i shkurtimeve buxhetore me vendim të qeverisë 1,977,113€, transferit të mjeteve në komuna për projektet e financuara nga huamarrja 662,256€, rritjes nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak 1,296,189€, si dhe donacionet e brendshme e të jashtme 700,416€.

Në vitin 2019, MASHT ka shpenzuar 86% të buxhetit final ose 62,770,301€, me një ulje prej 2% krahasuar me vitin 2018. Për realizimin e buxhetit më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

⁵ Të hyra nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit të ndara me ligj të buxhetit.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimi mit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	73,238,320	72,595,556	62,770,301	86%	49,447,601	41,528,363
Pagat dhe Mëditjet	19,815,991	20,143,227	18,641,975	93%	17,950,176	16,958,240
Mallrat dhe Shërbimet	17,756,888	23,269,996	20,994,126	90%	9,072,901	8,421,900
Shërbimet komunale	1,616,459	1,531,041	1,005,814	66%	987,151	1,022,455
Subvencionet dhe Transferet	6,278,497	3,122,689	2,564,236	82%	2,761,002	4,079,161
Investimet Kapitale	27,770,485	24,528,603	19,564,150	80%	18,676,371	11,046,607

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

Buxheti final për paga e mëditje krahasuar më buxhetin fillestar ishte rritur për 327,236€, ky buxhet ishte realizuar 93%. Ky nivel i realizimit ishte për faktin që numri aktual i të punësuarve ishte më i vogël se ai i buxhetuar dhe këtë vit nuk kishte rekrutime të reja;

Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar më buxhetin fillestar ishte rritur për 5,513,108€ apo 31%. Rritja vjen nga vendimet e qeverisë dhe nga të hyrat e bartura-grantet për shkak të mbulimit të shpenzimeve të shtuara për blerjen e librave për klasën 0-9;

Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,155,808€ apo 50%. Zvogëlimi ishte rezultat kryesisht i shkurtimeve buxhetore në fund të vitit për shkak të mos realizimit të disa aktiviteteve të rëndësishme të parapara si: aktivitetet e shkencës, programi "ERASMUS +" i cili ka të bëjë me bashkëfinancim për bursat në arsimin e lartë; konkursi për bursat e studentëve për vitin akademik 2019/20; mosrealizimi i "Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi financimin e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit" - Mitrovicë; dhe

Buxheti final për investime kapitale krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,241,882€ apo 12%. Zvogëlimi ishte shkaktuar nga kursimet buxhetore në vlerë prej 2,735,544€ për shkak të mosrealizimit të projekteve kapitale; reduktimi prej 538,880€ vjen nga transferi i ndarjeve buxhetore të fondit - financimi nga huamarrja nga MASHT në komuna për shkak të delegimit/bartjes së përgjegjësisë të realizimit të projekteve ligjërish tek këto organizata; si dhe rritjes nga donacionet prej 32,542€. Përkundër reduktimit të buxhetit realizimi ishte në nivel të 80%.

Çështja C1- Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. MASHT në 2019 përmes planifikimit buxhetor ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 1,191,332€ në kategori ekonomike jo adekuate, si:

- Pagesat në vlerë prej 1,118,209€ për blerjen e inventarit për objektet arsimore ishin buxhetuar dhe pastaj shpenzuar nga kategoria e investimeve kapitale e që sipas rregullave dhe natyrës së shpenzimit duhej të paguheshin nga kategoria mallra dhe shërbime;
- Pagesat në vlerë prej 50,000€ për anëtarësim të Kosovës në programin Erasmus⁶, ishin buxhetuar dhe pastaj shpenzuar nga kategoria e subvencione dhe transfere ndërsa sipas planit kontabël anëtarësimet janë shpenzime që i takojnë kategorisë mallra e shërbime, respektivisht, kodi - shërbime për anëtarësim (13470); dhe
- Riparimi i kulmit të Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Prizrenit, në vlerë prej 23,123€, ishte paguar dhe regjistruar nga mallrat e shërbimet ndërsa do të duhej të klasifikohesh si shpenzim kapital. Ky shpenzim kishte rezultuar nga nevoja e rregullimeve përkatëse për shkak të dëmtimeve në objekt.

Sipas menaxhmentit këto pagesa ishin pasojë e buxhetit të kufizuar nëpër kategoritë përkatëse e të cilat e kishin shkaktuar keqklasifikimin e shpenzimeve.

Ndikimi

Klasifikimi dhe pagesa e shpenzimeve nga kategoria ekonomike jo adekuate ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe në mbivlerësimin e pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të Pasqyrave Vjetore Financiare.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesat të realizohet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël. Një bashkëpunim efektiv me Ministrin e Financave do të lehtësonte gjetjen e zgjidhjeve, në mënyrë që të shmangen këto devijime.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MASHT ishin në vlerë 2,935,178. Nga këto të hyra, MASHT-it i ishte lejuar për shpenzime shuma prej 2,655,503€, ndërsa i kishte shpenzuar 1,130,159€.

Te hyrat që inkasohen kanë të bëjnë me participimin e studentëve, akreditimin e programeve akademike, qiraja etj. Nga testimi i 25 mostrave substantive dhe 5 mostra në pajtueshmëri nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për tu raportuar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të Hyrat	2,000,000⁷	2,000,000	2,935,178	147%	2,674,598	3,125,718

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 20,143,227€ dhe ishte realizuar 93%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2,267 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 2,150. Gjatë vitit 2019 nuk kishte të punësuar të rinj. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 223,458€, si dhe gjashtë mostra për teste të pajtueshmërisë.

⁶ Program për edukim, trajnim, rini dhe sport në bazë të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së MASHT dhe Komisionit Europian. Nga pjesëmarrja në këtë program përfitojnë të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë në projekte ndërkombëtare.

⁷ Shuma e buxhetit të planifikuar është vendosur nga të dhënat e Ministrisë së Financave

Çështja B1 – Kompensim i komisioneve të brendshme në kundërshtim me kërkesat ligjore

Gjetja

Sipas neni 80 të Ligjit për menaxhimin e financave publike nuk lejohet kompensimi shtesë nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizate buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.

Katër nga gjashtë Universitetet në kuadër të MASH⁸ me aprovime të këshillave drejtuese kishin përfshirë në rregullore kompensime shtesë për pjesëmarrje në disa lloje të komisioneve që konsiderohen si jo statutare.

Komisionet e tilla ishin për pjesëmarrje në hapje dhe vlerësimin e ofertave të prokurimit, regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë, planifikimin e buxhetit, pranimin e studentëve të rinj, për ankesa dhe parashtrësia, rekrutim të stafit, ndarjen e bursave, hartimin e strategjive dhe rregullores mbështetëse etj. Këto komisione ishin emëruar nga Rektorët e këtyre Universiteteve dhe ishin paguar. Vlera e kompensimeve të tilla për vitin 2019 ishte 42,750€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Organet e këtyre Universiteteve⁹ me rastin e përpilimit të rregullores përkatëse, nuk kishin marrë parasysh ndalesat ligjore për këto lloje të kompensimeve.

Ndikimi

Kompensimet shtesë për shërbimet që janë pjesë e detyrave të obligueshme të pozitës të cilin e mban punonjësi nuk janë të mbështetura me bazë ligjore, dhe si të tilla mund ta dëmtojnë buxhetin e Universiteteve përkatëse - ministrisë për vlerën e shpenzuar.

Rekomandimi B1 Ministri përmes mekanizmave përkatës ligjor në dispozicion¹⁰ të inicioj rishikimin e rregullores të universiteteve për kompensimet e komisioneve për një menaxhim efektiv të buxhetit të tyre.

⁸ Universiteti Ukshin Hoti – Prizren vlera 27,650€, Universiteti Fehmi Agani – Gjakovë vlera 2,845€, Universiteti i Shkencave të Aplikuara – Ferizaj vlera 3,010€, dhe Universiteti “Kadri Zeka” - Gjilan vlera 9,245€.

⁹ Universiteti i Gjakovës kishte marrë vendim me 17.07.2020 për pezullimin e përkohshëm të rregullores për kompensime deri në harmonizimin e rregullores me legjislacionin në fuqi.

¹⁰ Anëtarët e emëruar në këshillat drejtues të Universiteteve përkatëse nga ana e MASH⁸-it.

Çështja B2 – Mungesa e evidencës për vajtje - ardhjet në punë

Gjetja

Duke u bazuar në marrëveshjen e Brukselit, përkatësisht në Ligjin nr.04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës “Mbrojta Civile” e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Përmes këtij vendimi, obligohen ministritë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore.

Në MASHT, pas një procesi të rekrutimit me akt emërimi ishin integruar 32 nëpunës të komunitetit serb, ish pjesëtarë të “Mbrojtjes Civile”. Këta punonjës ishin planifikuar të sistemohen nëpër komunat në pjesën veriore të Kosovës. Megjithatë, në aktemërimet e tyre, të punësuarit janë sistemuar në pozita të caktuara brenda departamenteve përkatëse në ministri.

Për këta punonjës, MASHT, nuk ka dëshmi për ta konfirmuar paraqitjen e tyre në vendin e punës për ti kryer detyrat për të cilat janë të ngarkuar me kontrata, përderisa ishte bërë pagesa e rregullt e pagave të tyre. Vlera financiare për shpenzimet e pagave për vitin 2019, për këta 32 zyrtarë ishte 134,657€.

Kjo ka ndodhur për shkak se nuk janë zbatuar kontrole menaxheriale për të siguruar se të gjithë të punësuarit janë të pranishëm në vendin e punës gjatë orarit të punës dhe arsyeve tjera, përfshirë edhe rrethanat politike.

Ndikimi

Pagesa e pagave pa vijueshmëri në punë, shkakton dëmtim buxheti si dhe mos arritje të objektivave të përcaktuara me marrëveshje, pra integrimin e këtij komuniteti në sistemin e Republikës së Kosovës.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri duhet ta adresoj këtë çështje edhe në Qeveri.

Çështja A1 - Mangësi në zbatimin e rregullores për sistematizimin e vendeve të punës

Gjetja

MAShT me datën 26.09.2018, kishte aprovuar në qeveri Rregulloren (QRK) nr. 14/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës. Rregullorja kishte paraparë që MAShT të ketë pesë departamente apo tri më pak se që kishin ekzistuar. Bazuar në rregulloren e re kishte filluar procesi i riorganizimit të brendshëm dhe me 04.10.2018 me vendime të Sekretarit të Përgjithshëm ishin caktuar si Ushtrues Detyre (UD) tre drejtor të cilët kanë qenë me akt emërimi dhe dy drejtorë të ri si UD, ndërsa 5 drejtor aktual nuk ishin sistemuar në pozita të tilla.

Pas ankesave të bëra nga drejtorët që mbanin këto pozita, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil (KPMShC) me datën 21.12.2018 kishte nxjerr vendim për anulim të konkursit sepse citojmë: "MAShT nuk kishte ndërmarrë të gjitha veprimet siç parashihet me nenin 32 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe nuk kishte ndërmarr asnjë veprim që të gjej pozita ekuivalente ankuesve ashtu siç kërkohet me nenin 4 nën paragrafin 1.3 të Rregullores nr.08/2012 - për Nëpunës Civil Tepricë". Prandaj MAShT me 04.01.2019, kishte marr vendim për anulim të konkursit. Si rezultat i këtyre mangësive kemi gjetur se:

- Gjatë vitit 2019 ishin paguar 10 persona për UD të drejtorëve në vend se të ishin paguar pesë (5), siç e parasheh rregullorja e re; dhe
- Njëjtë ishte edhe me udhëheqësit e divizioneve ku katër (4) udhëheqës të divizionit nuk ishin sistemuar në pozita të udhëheqjes, por në vend të tyre janë caktuar punonjës tjerë me vendime si UD. Vlen të theksohet se për pozitat e udhëheqësve të divizionit nuk është iniciuar ndonjë proces rekrutimi.

Ndikimi

Pagesa e dy personave për të njëjtën post dhe të njëjtat detyra përveç që ishte në kundërshtim me rregulloren në të njëjtën kohë dëmton buxhetin publik.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të ndërmerr veprime konkrete për të zgjidhur çështjen e sistemimit dhe riorganizimin të stafit në harmoni me kërkesat ligjore. Funksionin e njëjtë nuk mund ta ushtrojnë dy punonjës andaj duhet shqyrtuar me seriozitet të gjitha mundësitë për zgjidhje përmes konkurseve për të eliminuar kontestet dhe kostot shtesë.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitetë) në vitin 2019 ishte 24,801,037€, prej tyre ishin shpenzuar 21,999,940€, apo 89%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me blerjen e librave dhe veprave artistike, shpenzimet për furnizim me ushqim për Qendrën e Studentëve, furnizim me material zyrtar, naftë për ngrohje qendrore, shërbime kontraktuese, shërbime komunale, udhëtime

zyrtare, shërbime të mirëmbajtjes etj. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 9,719,496€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit

Gjetja Sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (nenit 12 pika 4), emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

MAShT gjatë vitit 2019 kishte të angazhuar 167 (në administratën qendrore ishin 28) punonjës me marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MSHV). Ne analizuam pesë raste të angazhimeve përmes MSHV-ve, dhe identifikuam se ato ishin realizuar pa zhvilluar procedura të thjeshtuara të rekrutimit. Stafi ishte i angazhuar kryesisht për pozita të rregullta të punës dhe kontratat ishin për personat e njëjta nga viti 2018 e tutje me nga 6 muaj, pra këto kontrata vetëm ishin vazhduar.

Kjo kishte ndodhur për shkak se nuk ishin marrë parasysh kërkesat ligjore në lidhje me procedurat e thjeshtësuara të rekrutimit që kërkohen me rastin e angazhimeve të tilla.

Ndikimi Angazhimi i punonjësve me MSHV pa procedura të thjeshtësuara të rekrutimit kufizon konkurrencën dhe rrit rrezikun që përzgjedhja e stafit të jetë jomeritore dhe të bëhet në mënyrë jo transparente dhe si pasojë shërbimet e pranuar të mos jenë në përputhje me nevojat.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj se për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta zhvillohen procedura të thjeshtësuara të rekrutimit, në mënyrë që procesi të jetë transparent.

Çështja A3 - Aplikimi i aneks kontratave pa mbështetje ligjore

Gjetja Sipas nenit 38 pika 2 e Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik, kontrata kornizë nuk mund të lidhet në afat më të gjatë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen.

Universiteti i Prizrenit ka lidhur një aneks kontratë për shërbimet e pastrimit të objekteve me 15.04.2018 duke e bazuar në Kontratën Kornizë¹¹. Te kontratat kornizë nuk lejohet lidhja e aneks kontratave. Si rezultat i kësaj aneks kontrate jo ligjore për këto shërbime vetëm në vitin 2019 janë bërë pagesa në vlerë prej 82,488€, përderisa pagesa të tilla kishte që nga prilli i vitit 2018¹².

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte marrë parasysh rregullat e përcaktuara me ligj, ndërsa veprimin e kishte arsyetuar bazuar në njoftimin me shkrim që i kishte drejtuar KRPP-së.

Ndikimi Aplikimi i kësaj procedure është shmangie nga rregullat e prokurimit dhe pagesat e bëra mbi këtë bazë paraqesin pagesa të parregullta. Po ashtu, kjo shmangie ndikon edhe në parimet e transparencës dhe konkurrencës, dhe rrjedhimisht kontestohet nëse është arritur vlera për paratë e shpenzuara si rezultat i ndryshimeve të çmimeve në treg nga viti 2015.

Rekomandimi A3 Ministri dhe Rektori i Universitetit të Prizrenit duhet të ndërprejnë aplikimin e lidhjes së aneks kontratave dhe pagesave të parregullta si dhe të shqyrtohet mundësia e trajnimit për zyrtarët e prokurimit nga institucionet kompetente pasi që gabimet e tilla tregojnë mungesë të njohurive nga fusha e prokurimit.

¹¹ Kontrata Kornizë është lidhur për 36 muaj (15.04.2015 dhe ka qenë dhe skadimi i saj ka qenë me 15.04.2018)

¹² Pagesat për vitin 2018 ishin në vlerë prej 61,866€.

Çështja B3 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Në 27 pagesa për mallra dhe shërbime, kemi identifikuar se zotimi dhe urdhër blerja ishte bërë pas pranimit të faturës. Një praktikë e tillë po përsëritet vit pas viti për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 3,122,689€, prej tyre ishin shpenzuar 2,564,237€ apo 82%.

Këto shpenzime kanë të bëjnë kryesisht me pagesat e bëra nga MAShT për përkrahjen e studimeve dhe shkollimit të niveleve të ndryshme sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e ndryshme si: Sheffield-it, USAID, Fulbright, si dhe për përkrahjen e projekteve shkencore. Kemi testuar 24 mostra për teste substanciale në vlerë 935,212€ dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Mangësi në procedurat për subvencionimin e OJQ-ve

Gjetja Neni 6 i rregullores 04/2017¹³ kërkon nga OB-ja që të përgatis planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit dhe ta dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit. MASHT nuk ka përgaditur planin vjetor dhe proceduar pranë Zyrës së Kryeministrit.

Po ashtu, tetë marrëveshje për mbështetje financiare sipas thirrjes publike "Ofrimi i mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve" janë nënshkruar pas afatit¹⁴ të paracaktuar me nenin 22 i cili kërkon që ofruesi i mbështetjes financiare lidh kontratë me përfituesin brenda 90 ditësh nga dita e mbylljes së thirrjes publike.

Si shkaktar i këtyre vonesave ishte caktimi me vonesë i komisionit për vlerësimin e këtyre aplikacioneve, dhe numri i madhë i ankesave të aplikantëve.

Ndikimi Mos raportimi i planit pranë ZKM-së, rritë rrezikun që OJQ-të nuk janë të informuara me kohë për mundësitë e marrjes së subvencioneve nga Ministria përkatëse. Përderisa vonesat e procedurave brenda institucionit ndikojnë në mos arritjen me kohë të objektivave të ministrisë dhe që përfituesit të humbin mundësinë mbi zhvillimin e aktiviteteve në kohën e duhur.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj se plani vjetor për financimin e OJQ-ve raportohet sipas kërkesave ligjore pranë ZKM-së, dhe që janë eliminuar vonesat duke caktuar komisionet përkatëse me kohë për të respektuar afatet e përcaktuara me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve për subvencione.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 24,528,603€, prej tyre ishin shpenzuar 19,564,150€, apo 80%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e shkollave, furnizimi me pajisje për salla të edukatës fizike, furnizim me inventarë shkollor etj. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 9,780,093€, si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

¹³ Rregullore MF - nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve

¹⁴ Afati për nënshkrim ishte 10.07.2019 kurse marrëveshjet ishin nënshkruar me 30.07.2019

Çështja A5 - Mangësi në projektin - Gjuha shqipe dhe kompjuteri

Gjetja

MAShT me dt. 05.09.2019 kishte lidhur kontratë trevjeçare me procedurë të negociuar pa publikim për "Blerjen e Licencave për përdorim të pakufizuar kohor të softwerëve për gjuhën shqipe dhe kompjuterin" në vlerë prej 4,392,000€. Ministria kishte përgatitur planin ideor të këtij projekti, mirëpo nuk dihet se cilët zyrtarë staf e kanë përgatitur dhe hartuar këtë plan dhe nëse si i tillë ishte aprovuar nga menaxhmenti i Ministrisë. Menaxhimi i këtij projekti ishte përcjellur me mangësi nga fillimi i procesit si:

- MAShT në përputhje me nenin 6 pikën 3 të Rregullores nr. 06/2018¹⁵ i është drejtuar Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) për të marrë pëlqimin për iniciimin e projektit. Komisioni i ASHI-së ka vlerësuar që nuk është kompetent dhe ka sugjeruar që ky vlerësim të merret në Qeveri. Në përgjigjen e ASHI-së po ashtu është njoftuar MAShT-i se korrektuesi i gjuhës shqipe është i blerë (MAP) së bashku me licencat e Microsoftit si pako në Office 2016, dhe nuk duhej përfshirë në termat e referencës dhe të paguhej edhe njëherë. MAShT ka formuar një grup punues¹⁶ me përbërje nga institucionet qeveritare por që në termat e referencës kishte mbetur korrektuesi i gjuhës shqipe te pozicioni me nr.16;
- Menaxhmenti në vendimin e dt.10.09.2019 kishte caktuar menaxherin e projektit dhe organin mbikëqyrës të projektit (të cilin do ta përbëjnë inxhinierët e profileve adekuate nga divizioni për zbatimin e projektit). Ne nuk kemi gjetur dëshmi që ky organ është funksionalizuar dhe nëse është duke mbikëqyrur realizimin e projektit;

¹⁵ Rregullore (QRK) nr 06/2018 për menaxhimin e projekteve në fushën e teknologjies së Informacionit dhe Komunikimit.

¹⁶ Në përbërjen e grupit punues ishin Kryesuesi dhe anëtari nga MF dhe një anëtar nga Universiteti i Gjilanit

- Me 23.09.2019, MASht kishte paguar 1.5mil€ sipas raportit të pranimit të punëve ku ishte caktuar një vlerë për tri lloje të aplikacioneve (Licencave), përderisa një vlerë e tillë nuk ishte e specifikuar në kontratë apo në plan¹⁷ të menaxhimit të kontratës. Pra nuk ka ndonjë referencë (kontrata, Plani i menaxhimit të kontratës) si ishin caktuar këto vlera për këto pozicione; dhe
- Përfitues dhe përdorues të këtyre aplikacioneve sipas projektit janë qytetarët e vendit. Për këtë qëllim kërkohet që këta të jenë të informuar për ekzistencën dhe mundësinë e përfitimit dhe rrjedhimisht kërkon një informim të tyre për këtë mundësi. Ministria nuk ka ndërmarr një aktivitet informues lidhur me këtë mundësi të përfitimit të qytetarëve.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuara nga fillimi e deri te pjesa e parë e zbatimit të projektit tregojnë se ky projekt nuk është duke u menaxhuar siç duhet dhe rrjedhimisht rrit rrezikun që nuk do të merret vlera për paratë e shpenzuara.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të themeloj një komision nga ekspertët e fushës së projektit për të vlerësuar mbarëvajtjen e këtij projekti përfshirë edhe vlerësimin e pranimeve të realizuara deri më tani. Po ashtu, duhet të sigurohet që pagesat janë duke u bërë në pajtim me qëllimet e projektit, në përputhje me kornizën rregullative dhe që janë duke u marr kualitativisht produktet e projektit në pajtim me termat e referencës dhe kontratën.

¹⁷ Plani i menaxhimit të kontratës është i nënshkruar me dt.11.09.2019.

Çështja A6 – Dobësi në procesin e vlerësimit të ofertave

Gjetja Sipas nenit 56 pikës 3 të LPP-së, tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në dosjen e tenderit.

Në dosjen e tenderit për kontratën “Ndërtimi i shkollës fillore Ibrahim Mazreku-Malishevë”¹⁸, në kuadër të kapaciteteve teknike ishte kërkuar që OE të dëshmojnë pronësinë e mjeteve (për një kamion dhe dy eskavator) përmes noterizimit të librezave të automjeteve. Gjatë vlerësimit të ofertave kemi vërejtur se një ofertë është eliminuar¹⁹ nga komisioni me arsyen se librezat e qarkullimit të kamionit ishte me afat të skaduar. Librezat ishin të noterizuara ashtu siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit.

Komisioni i vlerësimit nuk kishte bërë përpjekje as përmes informatave/sqarimeve shtesë për të vërtetuar informatat e prezantuara dhe për tu siguruar në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional të ofertuesit.

Ndikimi Aplikimi i kriterëve që nuk ishin pjesë e dosjes së tenderit dhe mos kërkimi i informatave sqaruese nga ofertuesit më të lirë ndikon që të mos shpërblehet oferta më ekonomike.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të siguroj se me rastin e vlerësimit të tenderëve, komisioni i vlerësimit të marrë për bazë vetëm kriteret e vendosura me dosjen e tenderit duke i shterur të gjitha mundësitë ligjore për marrjen e ofertës më të lirë në mënyrë që buxheti i ministrisë të mos dëmtohet. Po ashtu, në rastet kur mungojnë informatat e plota duhet të aplikohet kërkesa për sqarime me qëllimin e vetëm që të merret oferta me kosto më ekonomike.

¹⁸ Kontrata ishte lidhur në vlerë prej 2,152,809€,

¹⁹ Ofertuesi i eliminuar ishte më i lirë se fituesi për 376,162€.

Çështja A7 - Mos konfiskim i sigurisë së tenderit

Gjetja

Sipas nenit 57 pika 1 të LPP-së: Siguria e tenderit do të konfiskohet, në rast se tenderuesi i ka dhënë AK informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese dhe nëse OE tërheq tenderin e tij pas afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Ne kemi gjetur se në dy procedura të prokurimit, nuk ishte konfiskuar siguria e tenderit edhe pse ishin krijuar rrethanat për t'u tërhequr e njëjta:

- Në procedurën e prokurimit për kontratën “Ndërtimi i shkollës fillore Ibrahim Mazreku - Malishevë”, njëri nga OE kishte ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta. Pas kërkesës së MASHT për bazën apo mbështetjen e kësaj oferte dhe çmimeve, i njëjti përmes një shkrese deklaroi se ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta “gabimisht”. Duke vepruar kështu, tenderuesi i kishte dhënë AK informacione përmbajtësish të gabueshme dhe në këto raste do të duhej t'i konfiskohej siguria e tenderit; dhe
- Në procedurën e prokurimit për kontratën “Renovimi i shkollës fillore Prapaqan-Deçan”, ofertuesi më i lirë ishte tërhequr nga nënshkrimi i kontratës me arsyen se, në ndërkohë ishte shpërblyer me kontrata tjera. Ofertuesi kishte tërhequr tenderin e tij pas afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Në situata të tërheqjes së ofertës neni 29.8 i RRUOP sugjeron AK të konfiskojë sigurinë e tenderit, gjë e cila nuk kishte ndodhur.

Kjo kishte ndodhur për shkak se MASHT nuk kishte respektuar kërkesat ligjore për konfiskimin e sigurimit të tenderit në rastet kur kërkohet.

Ndikimi

Mos konfiskimi i sigurimit të tenderit, përkundër se kishin ndodhur ngjarje apo rrethana që kërkonin një gjë të tillë tregon që MASHT nuk i kishte përdorur mekanizmat e vendosura duke dëmtuar konkurrencën dhe transparencën e procesit.

Rekomandimi A7 Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit se do të aplikohet konfiskimi i sigurisë së tenderit në rastet kur operatorët ekonomik i përmbushin kriteret për një gjë të tillë. Kjo do duhej aplikuar për të eliminuar qëllimet dhe informatat jo të sakta nga ana e OE-ve.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokatipale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 116,777,480€, pasurive jokatipale është 2,925,445€, si dhe e stoqeve 756,057€. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 29,773,904€, si dhe procesin e inventarizimit të pasurisë si test të pajtueshmërisë.

Çështja C2 – Dobësi në menaxhimin e pasurive kapitale dhe jokatitale

Gjetja

Rregullorja nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6, pika 3 përcakton që - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Respektivisht neni 19 pika 4.7 për Menaxhimin e Pasurive - raporti i inventarizimit duhet të kryhet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Lidhur me menaxhimin e pasurive ne kemi vërejtur si në vijim:

- Gjatë vitit 2019 pasuritë kapitale të blera në vlerë prej 989,745€, dhe ato jo kapitale në vlerë prej 97,826€ nuk ishin regjistruar në regjistrat përkatës dhe rrjedhimisht PFV e vitit 2019 ishin të nënvlerësuara për 1,087,572€. Duhet theksuar se këto pasuri ishin regjistruar në vitin 2020, pas diskutimeve tona me zyrtarët përkatës;
- Pasuritë në vlerë prej 706,350€ nuk ishin klasifikuar në regjistrat kontabël adekuat të pasurive, pasi që në vend që të klasifikohen te regjistri i e-Pasurive ishin klasifikuar gabimisht te regjistri i SIMFK-së. Kjo nuk ka pasur efekt në vlerën e përgjithshme të pasurive;
- Sistemi e-pasuria nuk ishte duke u përdorur në tetë²⁰ nën programe të MASHT-it dhe se pasuritë nën 1,000€ evidentohen në regjistra në exel që paraqet një rrezik në sigurinë e këtyre informatave duke pasur parasysh faktin që mund të fshihen dhe sistemi nuk lenë ndonjë gjurmë. Vlera e përgjithshme e këtyre pasurive është 2,241,267€; dhe
- Komisioni i inventarizimit të Administratës Qendrore të MASHT-it nuk e kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, siç kërkohet para përgatitjes së PFV-ve.

Dobësitë e identifikuara ishin reflektuar nga neglizhenca dhe kontrollet e brendshme joadekuate në lidhje me menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi

Angazhimi jo i mjaftueshëm për regjistrimin e plotë, në kohë dhe të saktë të pasurive dhe mos funksionalizimi i plotë i sistemit e-pasuria përfshirë edhe mos harmonizimin e regjistrat të pasurive me inventarizim reflekton në mbivlerësim/ nënvlerësim të informatave mbi gjendjen e pasurisë. Kjo rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet dhe njëherësh ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.

Rekomandimi C2 Ministri duhet të sigurojë kontrollë efektive në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive në çdo kohë. Më tutje, duhet të sigurojë që komisioni pas përfundimit të raportit të inventarizimit të bëjë harmonizimin e tij me regjistrat e pasurisë, para përgatitjes së PFV-ve me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen reale të pasurive me të cilat disponon organizata.

2.3 Të arkëtueshmet

MAShT në PFV e vitit 2019 ka shpallur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 43,902€ dhe krahasuar me një vit më parë, ka një ulje prej 6,160€. Këto kanë të bëjnë me të hyrat e pa inkasuara të qirasë dhe nga akreditimi i disa programeve.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 403,911€. Krahasuar me vitin 2018, ka një rënie të këtyre detyrimeve për 524,759€²¹. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Detyrimet e pa paguara kryesisht kanë të bëjnë me kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Arsye e mos shlyerjes së këtyre detyrimeve janë: mungesa e buxhetit, arritja me vonesë e faturave, mbyllja e vitit fiskal etj.

²⁰ Agjencia Kosovare e Akreditimit; Instituti Pedagogjik i Kosovës; Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve; Instituti Albanologjik i Kosovës; Agjencia për Aftësim dhe Arsim Profesional të të Rriturve; Qendra e Studentëve; Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"; Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"

²¹ Në 2018 obligimet e papaguara ishin 928,760€

Çështja A8 – Vonesa në pagesën e obligimeve dhe pagesat përmes vendimeve gjyqësore

Gjetja

Neni 39 i LMFPF përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Nga pesë mostrat e shqyrtuara të obligimeve të papaguara, në tri prej tyre ministria kishte tejkeluar afatin ligjor për kryerjen e pagesës për faturat përkatëse. Vonesat në pagesa ishin nga 1-15 muaj.

Vlera e pagesave të realizuara nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore ishte 92,166€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 78,692€ ndërsa 13,474€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës (përmbaramit). Pagesat kryesisht kishin të bënin me pagesat e tri pagave përcjellëse dhe pagës jubilarë me rastin e pensionimit të mësimdhënësve dhe mos pagesës së obligimeve me kohë. Arsyet e mos pagesës me kohë të obligimeve ishin kryesisht mungesa e buxhetit dhe në disa raste, pranimi me vonesë i faturave në financa.

Kjo pasi që, me marrëveshje kolektive të punësuarve të arsimit ju takon e drejta në pagë jubilarë dhe me rastin e pensionimit, kurse me buxhet nuk ishin ndarë mjete për këtë qëllim, kështu që të njëjtat ishin ekzekutuar përmes përmbaramesit bazuar në kontratat kolektive për arsimin në Kosovë.

Ndikimi

Tejkalim i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund të rezultojë në rritjen e pagesave përmes vendimeve gjyqësore, e këto pastaj ndikojnë në rritjen e kostos. Ministria për këto kosto shtesë nuk do të marrë në këmbim asnjë mall/shërbim.

Rekomandimi A8 Ministri duhet të sigurojë që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur dhe të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.

2.4.2 Detyrimet kontingjente

Vlera e detyrimeve kontingjente e shpalosur në PFV për vitin 2019 ishte 4,860,174€, me një rritje prej 361,511€ në raport me vitin e kaluar (2018 - 4,498,663€). Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së numrit të padive ndaj MASHT, me 12 padi të reja nga 36 sa kishte një vit më parë.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Vlera e detyrimeve kontraktuale në fund të vitit 2019 ishte 33,504,185€. Këto janë kontrata në vazhdim të MASHT dhe bashkëfinancime me Komuna (2019-2022), që kanë qenë të buxhetuara dhe të lidhura në afat më të gjatë se një vit, të cilat pritet të implementohen brenda tri viteve të ardhshme.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

MASHT ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor.

Për vitin 2019, kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik, ku kishte planifikuar nëntë auditime të rregullta dhe një sipas kërkesës. NjAB kishte arritur të realizojë nëntë auditimet e parapara në planin vjetor, ndërsa nuk kishte kërkesë për auditime të veçanta nga ana e menaxhmentit.

Në kuadër të auditimeve të kryera ishin përfshirë shumica e njësive organizative të MASHT, me prioritet sistemet me rrezik më të lartë, siç janë: planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit dhe procedurat e rekrutimit. Periudha e mbuluar kryesisht në raportet e NjAB përfshinte vitin e kaluar deri në kohën e përfundimit të auditimit përkatës. Numri i rekomandimeve të dhëna ishte 57 në këto raporte. Nga këto rekomandime 30 janë zbatuar, 19 janë në proces dhe 8 nuk janë zbatuar ende.

Çështja A9 - Mosfeksionimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja Udhëzimi Administrativ MF- nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në nenin 4 kërkon që çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar NjAB në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, duhet të themeloj edhe Komitetin e Auditimit (KA).

Në muajin maj anëtarët e Komitetit të auditimit të mëparshëm kishin dhënë dorëheqje dhe menaxhmenti nuk kishte marrë veprime për të përzgjedhur komitetin e ri. Gjatë vitit 2019, KA kishte arritur të mbante vetëm një mbledhje. Vlen të theksohet se MASHT me 23.06.2020 kishte marrë vendim për themelimin e KA-së.

Ndikimi Mosfeksionimi i plotë i KA mund të rrezikojë cilësinë e punës së NjAB-së dhe rrjedhimisht sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontroleve kyçe financiare. Po ashtu, do të mungojë edhe aktiviteti në nxitjen e menaxhmentit për implementimin e rekomandimeve.

Rekomandimi A9 Ministri duhet të marrë veprime për funksionalizimin efektiv të KA, në mënyrë që të sigurohet se roli dhe misioni i KA në ministri po përmbushet dhe funksioni i auditimit të brendshëm është i monitoruar mirë.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 ka rezultuar me 13 rekomandime. MASHT kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Ministria ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (me 30 shtator 2019, përderisa raportin e datës 15 mars 2020 nuk e kishin dërguar për shkak të situatës pandemike), sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, katër rekomandime janë zbatuar, tri ishin adresuar pjesërisht, tri nuk janë adresuar ende dhe tri të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri duhet të ndërmerr veprime konkrete lidhur me bartjen e pronësisë për shkollat e ndërtuara nga MASHT te komunat përkatëse dhe se këto pasuri duhet të largohen nga regjistri i pasurive të ministrisë. Më tutje, të shtoj kontrollet për të siguruar se të gjitha programet që janë në kuadër të MASHT do të përdorin sistemin e e-pasurisë për të siguruar se pasuria jokatiale e prezantuar në PFV paraqet një pamje të drejtë dhe të saktë. Gjithashtu, Ministri duhet të siguroj se projektet që për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve të mos planifikohen në kategorinë e investimeve kapitale por në kategorinë adekuate.	Është bërë bartja e pronësisë në shkolla dhe planifikimi në kode adekuate i një pjesë të shpenzimeve të rekomanduara. Mirëpo ka ende shpenzime që i takojnë mallrave të cilat janë planifikuar tek kapitalet. Me tutje, tetë programe të MASHT nuk e kanë përdorur sistemin e e-pasurisë. (C1 & C2).	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
2	Planifikim jo i mirë i projekteve	Ministri duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së buxhetit vjetor, zyrtarët përgjegjës do të bëjnë analiza të mirëfillta të kërkesave buxhetore për kategorinë e investimeve kapitale në mënyrë që vetëm projektet kapitale të përfshihen në tabelën përkatëse.	Është zbatuar rekomandimi për një pjesë të këtyre shpenzimeve që kanë të bëjnë me blerjen e librave, kurse blerja e inventarit ende ka mbetur e buxhetuar gabimisht por është trajtuar te C1.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
3	Realizim jo i mirë i buxhetit	Ministri duhet të mbikëqyrë në mënyrë sistematike ecuritë buxhetore të ministrisë dhe të planifikoj me kohë të gjitha aktivitetet që do të financohen me fondet e ndara buxhetore gjatë vitit aktual.		Rekomandim i mbyllur
4	Paga dhe mëditje	Ministri duhet të adresoj këtë çështje dhe të siguroj se nuk do të paguhen kompensimet për stafin e brendshëm të angazhuar brenda orarit të rregullt të punës. Mjetet e paguara për	Komisione të ngjashme janë paguar nga Universitetet brenda orarit për	Rekomandim i pa zbatuar

		kompensime për stafin të kthehen në buxhetin e ministrisë.	komisione të ngjashme.	
5		Ministri së bashku me Rektorin duhet të siguroj që pagesat të bëhen vetëm për orët e mbajtura jashtë norme dhe pagesat e bëra pa dëshmi për mbajtjen orëve mësimore, të kthehen në buxhetin e ministrisë.	Mjetet nuk janë kthyer në buxhetin e ministrisë pasi që profesorët në fjalë nuk janë më pjesë e UPZ.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar
6		Ministri së bashku me Rektorin duhet të sigurojë se të gjitha pagesat të pa arsyetura për kompensime ndaj anëtarëve të senatit të kthehen në buxhetin e Kosovës dhe në të ardhmen, të siguroj zbatim të rregullores përkatëse.	Është bërë kthimi i mjeteve dhe nuk kemi hasur në pagesa të ngjashme gjatë vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar
7		Ministri së bashku me Rektorët e universiteteve duhet të siguroj monitorim ndaj personelit akademik në mënyrë që angazhimet të jenë në harmoni me rregulloren për të ardhura personale rregulloren dhe për të gjitha rastet sikurse këto të përmendura të ndalohet dhe të rishikohet mundësia e kthimit të mjeteve dhe statusi i ardhshëm i angazhimit të këtij stafi.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar
8		Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri duhet ta adresoj këtë çështje edhe në Qeveri.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi. (B2)	Rekomandim i pa zbatuar
9	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin të procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi. Edhe këtë vit janë	Rekomandim i pa zbatuar

			identifikuar raste të njëjta. (B3)	
10	Investimet kapitale	Ministri duhet të merr masa të menjëhershme që pagesat e bëra për punët e pa kryera t'i kthehen buxhetit të ministrisë brenda një afati sa më të shkurtër, si dhe të siguroj një mbikëqyrje më efektive të projekteve në mënyrë që ekzekutimi i punimeve të kryhet në pajtim me kushtet e kontratës dhe pagesat të kryhen vetëm për punët e përfunduara.	Në vitin 2019, nga mostrat e ekzaminuara nuk kemi hasur në pagesa të tilla.	Rekomandim i zbatuar
11	Investimet kapitale	Ministri duhet të aplikoj kontrole përkatëse dhe të siguroj se me rastin e nënshkrimit të kontratave zyra e prokurimit vendosmërisht zbaton kërkesat që siguria e ekzekutimit të mbuloj tërë periudhën e përmbushjes së kontratave.	Në vitin 2019, nga dosjet e ekzaminuara nuk kemi hasur në raste të njëjta.	Rekomandim i zbatuar
12	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ministri duhet të siguroj që çdo fundvit të formoj komisione kompetente të inventarizimit të pasurive në kuadër të të gjitha programeve të ministrisë, si dhe rezultatet e inventarizimit të reflektohen në gjendjen e prezantuar në pasqyra financiare. Po ashtu, në rast nevoje, për anëtarët e komisioneve, të organizohen edhe trajnime të veçanta në mënyrë që procesi i inventarizimit të kryhet me kompetencë dhe në kohën e duhur.	Rekomandimi ishte zbatuar për kryerjen e inventarizimit të programeve në kuadër të MASHT, mirëpo harmonizimi me regjistër të pasurisë nuk ishte bërë. Shih rekomandimin C2.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
13	Obligimet e pa paguara	Ministri duhet të siguroj që të gjitha obligimet e papaguara të raportohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në PFV dhe më pas, me prioritet paguhen gjatë muajve të parë të vitit vijues.	Në vitin 2019, nga dosjet e ekzaminuara nuk kemi hasur në raste të njëjta.	Rekomandim i zbatuar

Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019
1	Planifikim i dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesat të realizohet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël. Një bashkëpunim efektiv me Ministrin e Financave do të lehtësonte gjetjen e zgjidhjeve, në mënyrë që të shmangen këto devijime.
2	Pagat dhe mëditjet	Ministri përmes mekanizmave përkatës ligjor në dispozicion të inicioj rishikimin e rregulloreve të universiteteve për kompensimet e komisioneve për një menaxhim efektiv të buxhetit të tyre.
3	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri duhet ta adresoj këtë çështje edhe në Qeveri.
4	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmerr veprime konkrete për të zgjidhur çështjen e sistemit dhe riorganizimin të stafit në harmoni me kërkesat ligjore. Funksinin e njëjtë nuk mund ta ushtrojnë dy punonjës andaj duhet shqyrtuar me seriozitet të gjitha mundësitë për zgjidhje përmes konkurseve për të eliminuar kontestet dhe kostot shtesë.
5	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj se për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta zhvillohen procedura të thjeshtëzuara të rekrutimit, në mënyrë që procesi të jetë transparent.
6	Mallrat dhe shërbimet	Ministri dhe Rektori i Universitetit të Prizrenit duhet të ndërprejnë aplikimin e lidhjes së aneks kontratave dhe pagesave të parregullta si dhe të shqyrtohet mundësia e trajnimit për zyrtarët e prokurimit nga institucionet kompetente pasi që gabimet e tilla tregojnë mungesë të njohurive nga fusha e prokurimit.
7	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

8	Subvencio net dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se plani vjetor për financimin e OJQ-ve raportohet sipas kërkesave ligjore pranë ZKM-së, dhe që janë eliminuar vonesat me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve për subvencione.
9	Investimet kapitale	Ministri duhet të themeloj një komision nga ekspertët e fushës së projektit për të vlerësuar mbarëvajtjen e këtij projekti përfshirë edhe vlerësimin e pranimeve të realizuara deri më tani. Po ashtu, duhet të sigurohet që pagesat janë duke u bërë në pajtim me qëllimet e projektit, në përputhje me kornizën rregullative dhe që janë duke u marrë kualitativisht produktet e projektit në pajtim me termat e referencës dhe kontratën.
10	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se me rastin e vlerësimit të tenderëve, komisioni i vlerësimit të marrë për bazë vetëm kriteret e vendosura me dosjen e tenderit duke i shterur të gjitha mundësitë ligjore për marrjen e ofertës më të lirë në mënyrë që buxheti i ministrisë të mos dëmtohet. Po ashtu, në rastet kur mungojnë informatat e plota duhet të aplikohet kërkesa për sqarime me qëllimin e vetëm që të merret oferta me kosto më ekonomike.
11	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se do të aplikohet konfiskimi i sigurisë së tenderit në rastet kur operatorët ekonomik i përmbushin kriteret për një gjë të tillë. Kjo do duhej aplikuar për të eliminuar qëllimet dhe informatat jo të sakta nga ana e OE-ve.
12	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Ministri duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive në çdo kohë. Më tutje, duhet të sigurojë që komisioni pas përfundimit të raportit të inventarizimit të bëjë harmonizimin e tij me regjistrat e pasurisë, para përgatitjes së PFV-ve me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen reale të pasurive me të cilat disponon organizata.
13	Detyrimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur dhe të gjitha faturat e pranuarra paguhen brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.
14	Auditimi i brendshëm	Ministri duhet të marrë veprime për themelimin dhe funksionimin efektiv të KA, në mënyrë që të sigurohet se roli dhe misioni i KA në ministri po përmbushet dhe funksioni i auditimit të brendshëm është i monitoruar mirë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmim



Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjies, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Agim Bërdyna
u.d. Sekretar i Përgjithshëm MASH

Data: 24 Korrik 2020, Prishtinë,